

NATO-ja RISTRUKTURON KOMANDËN PËR TA FORCUAR SIGURINË NË VERI

PRISHTINË, 5 DHJETOR - NATO këtë javë do t'i integrojë vendet nordike në Komandën e Përbashkët të Forcave në Norfolk të Shteteve të Bashkuara, në një përpjekje për ta përmirësuar sigurinë transatlantike dhe për ta forcuar pozicionimin e aleancës në veri, tha komandanti kryesor i NATO-s, Alexis Grynkeuich, për gazetaret më 4 dhjetor. Nën strukturën e re, të gjitha vendet nordike do të jenë në selinë e vendosur në portin e Norfolkut në Virxhinia të ShBA-së, që është e orientuar në mbrojtjen e Atlantikut të Veriut, në vend të disa shteteve në

rajon që mbeten nën komandën e NATO-s në Brunsum të Holandës, që është përgjegjëse për krahun verilindor të aleancës. Finlanda iu bashkua NATO-s në vitin 2023 dhe Suedia në vitin 2024, pasi pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022 i shtyu të dy shtetet që t'i rishikonin strategjitë e tyre kombëtare të sigurisë. Anëtarësimi i tyre në aleancën ushtarake perëndimore me 32 anëtarë ka forcuar pozicionin e NATO-s në veri dhe në rajonin e Detit Baltik, duke çuar në ristrukturimin e komandës. "Me rreshtimin e kundërshtarëve tanë në mbarë

botën, është e domosdoshme të forcojmë sa më shumë zonën euroatlantike dhe të konsolidojmë pozitën tonë në veri", tha Grynkeuich, gjeneral i Forcave Ajrore të ShBA-së dhe komandant suprem i NATO-s për Evropë. Ai këto deklarata për gazetarë i bëri në selinë ushtarake të aleancës në qytetin belg të Monsit. "Norfolk është ura strategjike midis Amerikës së Veriut dhe Evropës", theksoi ai. Komanda e Norfolkut do të jetë përgjegjëse për Arktikun, Danimarkën, Finlandën, Grenlandën, Islandën, Norvegjinë, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar.



SERWERI: SERBIA MBETET BURIMI KRYESOR I DESTABILIZIMIT NË BALLKAN



Prishtinë, 5 dhjetor - Komiteti për Evropën i Komisionit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve në ShBA mbajti të martën një seancë dëgjimore me temën "Pika e nxehtë: rruga drejt stabilitetit në Ballkanin Perëndimor". Në një analizë të publikuar në Peacefare.net, profesori amerikan Daniel Serwer vlerësoi se, ndonëse rajoni ende nuk është "pikë e nxehtë", ai shumë lehtë mund të kthehet në të tillë. Sipas tij, problemi kryesor nuk është mungesa e stabilitetit, por mungesa e ndryshimit politik demokratik, pasi "stabiliteti

aktual mbahet përmes korrupsionit, tensioneve etnike dhe autokracisë". Gjatë seancës, dëshmitarët dhe anëtarët e Kongresit amerikan u pajtuan se Serbia mbetet një prej faktorëve më të mëdhenj destabilizues në Ballkan për shkak të korrupsionit të përhapur, qeverisjes gjithnjë e më autokratike, lidhjeve të ngushta ushtarake e tregtare me Kinën si dhe marrëdhënieve të forta politike e ekonomike me Rusinë. Serweri shtoi se përpjekjet vitet e fundit për ta orientuar Serbinë drejt Perëndimit kanë dështuar. Sipas tij, presidenti serb

Aleksandar Vuçiq nuk ka asnjë interesim ta frenojë korrupsionin, të distancohet nga Moska dhe Pekini, apo të garantojë më shumë liri mediatike dhe pavarësi të sistemit të drejtësisë. Duke folur për situatën në Kosovë, Serweri theksoi se vendi ka nevojë për më shumë sovranitet, jo më pak. Ai paralajmëroi se statusi i paqartë i Kosovës krijon hapësirë për ndikim rus dhe kinez. "Mbështetja e pakushtëzuar për Kosovën duhet të jetë prioritet, sidomos përballë presionit serb", deklaroi ai.

PUTINI DHE MODI BISEDOJNË PËR TREGTINË DHE PAQEN NË TAKIMIN NË NJU-DELHI

NJU-DELHI, 5 DHJETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, dhe kryeministri i Indisë, Narendra Modi, i filluan bisedimet në takim në Nju-Delhi të premten, duke folur për tregtinë mes vendeve të tyre dhe për paqen në Ukrainë. India e priti liderin rus me tapet të kuq dhe Modi i tha atij se India i mbështet përpjekjet për paqe në Ukrainë. Kjo është vizita e parë e Putinit në Indi pas katër vjetësh, dhe synimi i tij është ta rrisë tregtinë me blerësin kryesor të armëve dhe naftës së transportuar përmes detit nga Rusia, në një kohë kur sanksionet perëndimore po ushtrojnë tryzni mbi lidhjet e tyre shumëvjeçare. Vizita po ndodh në një kohë kur Nju-Delhi është i angazhuar në bisedime me Shtetet e Bashkuara për një marrëveshje tregtare që synon uljen e tarifave ndëshkuese të vendosura nga

presidenti Donald Trump mbi mallrat indiane për shkak të blerjes së naftës ruse nga India. Moska ka qenë furnizuesja e kryesor e armëve për Indinë prej dekadash dhe ka thënë se dëshiron të importojë më shumë mallra indiane në përpjekje për ta çuar tregtinë në 100 miliardë dollarë deri në vitin 2030, tregti e cila deri më tani ka qenë kryesisht në favor të Rusisë për shkak të importeve indiane të energjisë. Qëkurse vendet evropiane ulën varësinë ndaj energjisë ruse pas pushtimit të Ukrainës pothuajse katër vjet më parë, India rriti blerjet e naftës ruse me zbritje, para se t'i ulte sërish këtë vit si pasojë e trysnisë së tarifave dhe sanksioneve amerikane. "India nuk është neutrale, India ka një qëndrim, dhe ky qëndrim është për paqe", i tha Modi Putinit në hapje të bisedimeve. "Ne



mbështesim çdo përpjekje për paqe dhe qëndrojmë krah për krah me çdo nismë të ndërmarrë për paqe", shtoi ai. Putini, në përgjigje, e falënderoi Modin për vëmendjen dhe përpjekjet e tij për ta gjetur një zgjidhje për konfliktin. "Ne patëm mundësi, dhe ju ma dhatë këtë mundësi, të flasin në hollësi për atë që po ndodh në drejtimin

ukrainas dhe për hapat që po ndërmarrim së bashku me disa partnerë të tjerë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, drejt një zgjidhjeje të mundshme paqësore të kësaj krize", tha Putini. "Ndërsa vendet dhe ekonomitë tona rriten, edhe mundësitë për bashkëpunim po zgjerohet", shtoi ai.

India dhe Rusia pritet të nënshkruajnë një sërë marrëveshesh në fund të bisedimeve zyrtare. Modi dhe Putini pritet të diskutojnë gjithashtu çështje që përfshijnë fuqinë punëtore dhe energjinë bërthamore civile. Putini mbërriti në Indi një ditë pasi zhvilloi bisedime me të dërguarit kryesorë të Trumpit për një marrëveshje të mundshme paqeje për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, por ata nuk arritën ndonjë kompromis. India nuk ka pranuar ta dënojë Rusinë për luftën dhe ka bërë thirrje për paqe përmes dialogut dhe diplomacisë, ndërkohë që ka thënë se lidhjet e saj me Moskën janë vënë padrejtësisht në shënjestër nga vendet perëndimore, të cilat, sipas Indisë, kanë vazhduar të bëjnë biznes me Moskën kur ka qenë në interesin e tyre.

GJYKIMI NDAJ THAÇIT PËR PENGIM TË DREJTËSISË NIS NË SHKURT TË VITIT 2026

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Gjykimi ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe katër të akuzuarve të tjerë për pengim të drejtësisë, do të nisë më 24 shkurt të vitit 2026, njoftuan Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Aktakuza e re kundër Thaçit dhe ndaj ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, dhe Fadil Fazliut - u konfirmua më 29 nëntor, ndërsa u bë publike në dhjetor.

Në parashtrimet e dorëzuara, Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte thënë se që gjykimi të zgjasë “jo më shumë se dy javë” dhe se tre dëshmitarët e saj për këtë çështje do të dëshmojnë brenda një jave.

Në parashtrimet e mbrojtjes së Thaçit, avokatët kishin deklaruar se dëshironin që gjykimi të niste në mars për shkak të afateve të tjera procedurale për gjykimin tjetër të Thaçit, ku ai së bashku me ish-krerët e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po përballen me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Sikurse mbrojtja e Thaçit, ashtu edhe ajo e Smakajt, Kilajt, Fazliut dhe Kuçi kanë argumentuar se ZPS-ja nuk mund ta vazhdojë hetimin “në afat të pacaktuar” për këtë çështje. Mbrojtja e Kuçi ka thënë se Prokuroria duhet t'i përmbyllë hetimet para nisjes së gjykimit.

Për çfarë akuzohet Thaçi dhe të tjerët?

Thaçi akuzohet se bashkërendoi “tri grupe të veçanta” së bashku me Smakajn, Kilajn, Kuçin dhe Fazliun për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë në rastin kundër tij dhe të tjerëve për krime lufte.

Në aktakuzë përmendet vizita e 2 korrikut e vitit 2023 e Fadil Fazliut në qendrën e paraburgimit në Hagë, ku u takua me Thaçin. “Gjatë vizitës Hashim Thaçi dha informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së” për çështjen kundër tij. Aty thuhet se ai i dha Fazliut “udhëzime të hollësishme që Fazliu duhej t'ia përcillte dëshmitarit të ZPS-së ose se si duhej të dëshmonte dëshmitari 1”.

Aktakuza pretendon se Thaçi dhe Fazliu u pajtuan për mënyrën se si të jepnin udhëzime dhe u morën vesh që djali i Fazliut, F. Fazliu, të kontaktonte me dëshmitarin 1 për caktimin e një takimi.

ZPS pretendon se Fadil Fazliu dhe djali i tij ishin takuar më herët me dëshmitarin dhe kishin këmbyer mesazhe telefonike më 26 qershor dhe më 3 korrik, po

ashtu, duke caktuar një takim më vonë gjatë 3 korrikut 2023, “në përputhje me udhëzimet e Hashim Thaçit për Fadil Fazliun”. Prokuroria pretendon se në kohën kur Thaçi u takua me Fazliun, dëshmitari 1 nuk kishte bërë publike se do të ishte dëshmitar në Hagë dhe dëshmia e tij ishte klasifikuar si konfidenciale.

Aktakuza prej 15-faqesh, përmend edhe një vizitë më 3 shtator të vitit të kaluar të Hajredin Kuçi, i cili vizitoi Thaçin në qendrën e paraburgimit.

Edhe aty thuhet se Thaçi e kishte udhëzuar Kuçin se si t'ua përcillte dëshmitarëve se si duhej të dëshmonin. “Hajredin Kuçi në mënyrë të përsëritur konfirmoi dhe/ose u pajtua me udhëzimet e Hashim Thaçit lidhur me ndikimin ndaj dëshmitarëve dhe dha sugjerime në lidhje me udhëzimet që duhej t'u jepeshin dëshmitarit 5 dhe dëshmitarit 6. Hajredin Kuçi gjithashtu konfirmoi se kishte takuar më parë dëshmitarin 5 të paktën një herë për të diskutuar dëshminë e dëshmitarit 5”, thuhet në aktakuzë.

Për ish-kreun e AKI-së, Bashkim Smakaj, ZPS tha se ai, së bashku me B. Sh dhe A. B vizituan Thaçin në qendrën e paraburgimit më 9 shtator 2023. Edhe gjatë këtij takimi, ZPS-ja pretendon se Thaçi dha informacione konfidenciale për dëshmitarët në rastin ndaj tij dhe udhëzoi “një apo disa nga vizitorët” që t'i jepnin udhëzimet dëshmitarit 2 si të dëshmonte në rastin ndaj tij. “Hashim Thaçi e cilësoi dëshminë e dëshmitarit 2 si vendimtare dhe dha udhëzime të hollësishme se çfarë duhej të thoshte dëshmitari 2 gjatë dëshmisë së tij. Hashim Thaçi u kërkoi vizitorëve që të vinin ta takonin sërish pas një muaji në qendrën e paraburgimit”, thuhet në aktakuzë. Aty shtohet se Smakaj dhe A. B u takuan sërish me Thaçin më 7 tetor, siç pretendohet, për t'u dhënë udhëzime të mëtejme se si duhej të dëshmonte dëshmitari 2.

ZPS-ja tha se gjatë kontrollit të makinës së Smakajt më 30 tetor 2023 janë gjetur dokumente ku trajtohej tema e dëshmisë që pritej të jepte dëshmitari 2 “me një version të ngjarjeve që përputhej me udhëzimet e dhëna nga Hashim Thaçi gjatë vizitave në qendrën e paraburgimit më 9 shtator dhe 7 tetor 2023”.

Edhe për këtë dëshmitar, ZPS-ja tha se ai nuk e kishte bërë publike statusin e tij dhe Dhomat e Specializuara e kishin mbrojtur identitetin e tij duke e intensifikuar vetëm me kodin e tij të dëshmitarit.

Sa i përket Isni Kilajt, ai së bashku me V. K. e kishin takuar Thaçin në Hagë më 6 tetor në qendrën e paraburgimit, u tha në



aktakuzë.

Gjatë kësaj vizite, ZPS pretendon se Thaçi u ka dhënë të dhëna konfidenciale për dëshmitarë në rastin kundër tij, me udhëzime për dëshmitarin 4 - dëshmitar i mbrojtur - “se si duhej të dëshmonte”.

Gjatë dhënies së udhëzimeve, Hashim Thaçi dha referenca dhe pjesë të deklaratave konfidenciale të mëparshme të dëshmitarit 4. Gjithashtu, Thaçi diskutoi provat konfidenciale të dëshmitarit 3”, u tha në aktakuzë. Në aktakuzë u tha se gjatë kontrollit të pronës së Kilajt më 2 nëntor 2023, janë gjetur materiale “me informacione konfidenciale për proceset e Dhomave të Specializuara të Kosovës [DHSK] dhe të dhëna identifikuese të dëshmitarëve të mbrojtur, përfshirë dhe emrat e dëshmitarëve”, duke shtuar se konkretisht janë gjetur faqe të grisura të deklaratave të dëshmitarit 4, “ndër të cilat edhe pjesë së cilës Thaçi iu referua gjatë vizitës së 6 tetorit 2023”.

Po ashtu, ZPS-ja tha se janë gjetur fletë të një fletoreje, ku pretendohet se kishte

përmbledhje të dëshmitarëve aktualë dhe me kodet e tyre të dëshmitarëve.

Në aktakuzë thuhet se Thaçi, së bashku me Fazliun, Smakajn, Kilajn dhe Kuçin, kanë penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrës së tyre. Aty thuhet se ish-presidenti i Kosovës ka drejtuar këto përpjekje përmes vizitave të paprivileguara që ka zhvilluar në qendrën e paraburgimit në Hagë. Në aktakuzën e re, Thaçi ngarkohet me tri akuza për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; katër akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe katër akuza për mosbindje ndaj gjykatës. Fazliu, Smakaj dhe Kilaj akuzohen për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe për mosbindje ndaj gjykatës. Deri më tani Dhomat e Specializuara kanë dënuar disa persona për akuzat që lidhen me pengimin e drejtësisë.

Në shkurt të këtij viti, pas marrëveshjes së pranimi të fajësisë u dënuan dhe u shpallën fajtorë Haxhi Shala, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari. Të tre e kishin pranuar fajësinë për frikësim të dëshmitarëve dhe për pengim të drejtësisë, pasi arritën marrëveshje me Prokurorinë e Specializuar për pranim të fajësisë në fund të dhjetorit 2024. Ndërkaq, më herët janë dënuar edhe dy ish-figura të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Gjykata në Hagë, po ashtu, ka shqiptuar dy aktgjykime për krime lufte.

Kjo gjykatë u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. (Radio Evropa e Lirë)



SHARJE PËR VOTA: PROGRAMET MBETEN NË HIJE

Gjuha fyese është bërë përditshmëri në fjalorin e partive, duke zëvendësuar debatet mbi programet zgjedhore, veçanërisht në prag të zgjedhjeve të 28 dhjetorit. Sulmet dhe akuzat ndaj kundërshtarëve përdoren për ta mobilizuar bazën dhe për ta maksimizuar ndikimin te votuesit, thonë vëzhguesit, duke paralajmëruar edhe për rrezikun ndaj demokracisë. Zgjidhja shihet te veprimi nga të gjithë aktorët shoqërorë deri te mediet

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Termat ofendues dhe denigrues, si “hajvan”, “njeri i Serbisë”, “të shitur”, “hibridë”, “Vukvendosje”, “sekt politik” e të tjera, janë bërë pjesë e fjalorit të pothuajse të gjitha partive kryesore politike në Kosovë. Gjuha e tillë, e përdorur publikisht nga politikanët prej vitesh, ka arritur kulmin në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, vlerësojnë përfaqësues të shoqërisë civile, analistë dhe ekspertë të sjelljeve shoqërore dhe medieve. Fushata zyrtarisht nis më 17 dhjetor, por partitë politike i kanë nisur tashmë aktivitetet e tyre: takime me qytetarët, adresime publike dhe debate televizive. Ajo që bie në sy është fokusi i tyre - më shumë te sulmet dhe akuzat ndaj njërit-tjetrit, dhe thuajse aspak te prezantimi i programeve zgjedhore. “Në vend të debatit

mbi ide, politika shihet si një luftë ndërmjet [njerëzve] ‘të mi’ dhe ‘tuaj’”, thotë Mexhide Demolli nga Lëvizja FOL - pjesë e rrjetit të organizatave joqeveritare Demokracia në Veprim, e cila monitoron fushatat dhe proceset zgjedhore në Kosovë. “Një kulturë e tillë e ofendimit, fatkeqësisht, shihet si forcë, e që konsideroj se është gabim”, shton ajo.

Fjalët armiqësore si “strategji e qëllimshme”

Analisti politik Artan Muhaxhiri e sheh gjuhën denigruese si pasojë e tendencës së partive politike për përfitime maksimale elektorale. Si shembull ai përmend Lëvizjen Vetëvendosje dhe udhëheqësin e saj, Albin Kurti, që në dy palë zgjedhjet e fundit parlamentare - shkurt 2021 dhe shkurt 2025 - arritën rezultatin më të mirë,

por pa suksese të mëdha në programin politik apo ekonomik, sipas tij. “Kësisoj, fjalët armiqësore janë shndërruar në modelin më joshës për t’i arritur majat e pushtetit”, thotë Muhaxhiri. “Përzgjedhja e këtij formati të veprimit politik edhe nga partitë ish-opozitare, gjithsesi është indikator i mungesës drastike të ideve, guximit dhe - ç’është më e rëndësishmja - vetëdijes emancipuese për urgjencën e të sfiduarit kritik”, shton ai për Radion Evropa e Lirë. Në vitin 2021, Lëvizja Vetëvendosje fitoi mbi 50 % të votave dhe tri partitë e tjera të mëdha mbetën jashtë pushtetit. Në zgjedhjet e 9 shkurtit, Vetëvendosja doli sërish e para, por pa arritur ta sigurojë shumicën për të qeverisur vetë. Dështimi për ta formuar qeverinë çoi më pas drejt zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit. Muhaxhiri thekson se mungesa e platformave vizionare, të bazuara në ekspertizë, zëvendësohet me polarizime dhe etiketime njolllosëse ndaj kundërshtarëve. Sipas tij, kjo retorikë fyese synon motivimin e votuesve përmes ngarkesës emocionale negative, duke minimizuar përgjegjësinë etike për të kontribuar në mënyrë konstruktive. Demolli, gjithashtu, e sheh këtë si një strategji të qëllimshme:

gjuha e ashpër mobilizon bazën militante të partive dhe krijon ndjenjën e urgjencës: “Nëse nuk votoni për ne, do të ketë katastrofë”. “Kjo i shtyn njerëzit të dalin në votime në ditën e zgjedhjeve”, thotë Demolli. Për t’i mobilizuar votuesit, ajo thotë se partitë politike, gjithnjë e më shumë, përdorin gjuhë fyese ndaj kundërshtarëve edhe në rrjetet sociale, ku marrin numër të madh shikimesh e komentesh. Kështu “edhe injorohen debatet mbi programet zgjedhore dhe çështjet e rëndësishme si buxheti, arsimi e shëndetësia”, sipas saj.

Përplasjet në rrjetet sociale

Alban Zeneli, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se partitë politike, si gjeneratore të gjuhës së ashpër fyese dhe denigruese, e kanë polarizuar shoqërinë. Ky polarizim jo rrallë ushqehet edhe në debate televizive, thekson ai. “Sado që mund të kemi një rol të caktuar të medias, në kuptimin e zbutjes së asaj gjuhe, problemi kryesor qëndron te gjeneratoret e kësaj gjuhe, që janë partitë politike”, thotë Zeneli për Radion Evropa e Lirë. Ai shpjegon se barazimi i kundërshtarit politik me

armikun është karakteristikë kryesore e gjuhës që përdoret në rrjetet sociale. “Kjo, sipas tij, vjen në një kohë që njihet si ‘post-truth’, apo ‘përtej së vërtetës’, në të cilën ‘njerëzit nuk janë të interesuar të dëgjojnë më argumentet dhe faktet objektive’, por janë më të interesuar ‘të dëgjojnë në mënyrë emocionale një rrëfim që është i përshtatshëm për ta’”. “Kjo epokë në të cilën po jetojmë, e cila karakterizohet me këtë që po e diskutojmë, është shumë e përshtatshme për këtë gjuhë politike që po e përdorin politikanët”, thotë Zeneli për Radion Evropa e Lirë. Sociologu Artan Krasniqi thekson se gjuha shpreh jo vetëm mendim, por edhe veprim. Për shkak të mungesës së ofertave politike reale, sipas tij, partitë luajnë rolin e viktimës dhe përdorin ide bllokuese dhe polarizuese, që janë të dëmshme për shoqërinë. “Kjo politikë e viktimizimit ose politikë e kërkesës së kundërshtarit - nuk po them armikut - tingëllon ose vlerësohet si e efektshme për të mobilizuar dhe elektrizuar votuesin”, thotë profesori i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës. Ai shton se kjo gjuhë e ashpër, me fyerje dhe denigrime, motivon jo vetëm militantët e partive, por edhe qytetarët e zakonshëm për ta përdorur të njëjtën. “Kur i thonë ‘hajvan’

THEMELORJA REFUZON KËRKESËN E BESIM KELMENDIT, AI PARALAJMËRON ANKESË NË APEL

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka refuzuar padinë e Besim Kelmendit përmes së cilës ai kërkoi masë të përkohshme të sigurisë dhe pezullim të vendimit të Këshillit Prokurorial (KPK) për shkarkimin e tij nga pozita e ushtruesit të detyrës të Kryeprokurorit të Shtetit. Avokati i tij ka paralajmëruar ankesë në Gjykatën e Apelit, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Nga Gjykata Themelore konfirmuan për “Radion Evropa e Lirë” se më 4 dhjetor është marrë vendim për padinë e Kelmendit ndaj KPK-së dhe se i njëjti u është dërguar palëve. Gjykata Themelore ka argumentuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e masës së përkohshme, siç parashihet në Ligjin për Konfliktet Administrative. Po ashtu, kjo gjykatë ka konstatuar se pretendimet për dëm të reputacionit dhe atë profesional nuk janë mbështetur në fakte konkrete. Ky institucion tha se pezullimi i vendimit të KPK-së për shkarkimin e Kelmendit, do ta cenonte interesin publik, do të krijonte paqartësi institucionale si dhe do t'i ndërpriste proceset e rregullta vendimmarrëse në sistemin prokurorial. Avokati i Kelmendit, Flakron Sylejmani i tha “Betimit për Drejtësi” se vendimi i Themelores ka të bëjë vetëm me kërkesën për masë të përkohshme dhe se ligjshmëria e vendimit për shkarkim nuk është vlerësuar.

Më 25 nëntor Themelorja konfirmoi se kishte pranuar padinë e dorëzuar nga Kelmendi që kontestonte vendimin e KPK-së të datës 20

nëntor. Kelmendi në padi ka argumentuar se ky vendim është marrë pa kuorum dhe pa respektim të procedurave ligjore. KPK-ja, ndërkaq, i kishte kërkuar Themelores që ta refuzonte kërkesën e Kelmendit për masë të përkohshme, duke argumentuar se posti i u. d. Kryeprokurorit nuk përbën mandat të garantuar ligjor dhe është funksion i përkohshëm dhe i zëvendësueshëm. KPK-ja ka thënë se largimi i Kelmendit nga kjo pozitë nuk e ka cenuar statusin e tij profesional, pasi ai vazhdon të jetë prokuror i shtetit, pa humbur të drejtën e punësimit dhe pagës. Vendimi për shkarkimin e Kelmendit ishte kontestuar nga organizatat joqeveritare që monitorojnë sistemin e drejtësisë, që kishin argumentuar se ai ishte një vendim i marrë në mungesë kuorumi në mbledhjen e KPK-së dhe se ishte një vendim “i paligjshëm, arbitrar dhe abuziv”.

Për vendimin ka reaguar edhe faktori ndërkombëtar. Ambasada Amerikane në Prishtinë ka bërë thirrje që të respektohen ligjet dhe të ndiqen procedurat e duhura ligjore, ndërkaq Zyra e Bashkimit Evropian ka vlerësuar se shkarkimi i Kelmendit pengon reformat e nevojshme në KPK dhe shpërfill parimet e ligjit dhe minon përparimin e shtetit drejt bllokut evropian.

Reçaku

KPK-ja mori vendim për shkarkimin e Kelmendit një ditë pasi ai u paraqit në Prokurorinë Speciale të Kosovës si dëshmitar lidhur me punën e tij



në gjykatë në kohën kur ka ndodhur masakra e Reçakut. Kelmendi në një konferencë për medie të mbajtur më 19 nëntor i mohoi raportimet se kishte bashkëpunuar me gjyqtaren serbe, Danica Marinković, më 1999, e cila e kishte përsipër rastin e masakrës së Reçakut. Atëbotë Marinković punonte si gjyqtare në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe e kishte cilësuar masakrën si “ngjarje të trilluar”.

Në atë masakër u vranë 45 civilë shqiptarë. Kelmendi ka konfirmuar se është paraqitur në Prokurori si dëshmitar. Sipas tij, në atë periudhë ishte i punësuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë si bashkëpunëtor profesional, duke theksuar se kryente punën e procesmbajtësit, andaj

i mohoi akuzat se ishte asistent i Marinkovićit. Deklarimet e tij erdhën pas pretendimeve të medias lokale në Kosovë, “Paparaci”, se Kelmendi kishte qenë i përfshirë në trajtimin e rastit të Reçakut më 1999. Sipas tij, Marinković ishte gjyqtarja që “zhdukuri provat për masakrën e Reçakut”.

Pretendimet e atëhershme të gjyqtares serbe, Marinković, për masakrën e Reçakut, janë në linjë të njëjtë edhe me narrativën e tanishëm që kanë autoritetet serbe për këtë ngjarje. William Walker, që gjatë vitit 1999 kishte shërbyer shëf i Misionit Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), kishte dokumentuar

krimet e kryera në këtë fshat. Pas masakrës së Reçakut, në mars të vitit 1999, NATO-ja i sulmoi caqet ushtarake policore në ish-Jugosllavi. Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet janë ndërprerë më 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë kishte mundësuar edhe kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800.000 refugjatëve, personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Afër 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Lushtaku dhe Nura ndërrojnë pozitat

Skenderaj, 5 dhjetor - Kryetari i ri i Skenderajt, Sami Lushtaku, një ditë më parë ka dhënë betimin si kryetar komune, ndërkaq të premten ish-kryetarin Fadil Nura e ka emëruar nënkryetar komune. “Me vendimin tim të parë si kryetar i komunës së Skenderajt, kam emëruar

Fadil Nurën si nënkryetar komune, një mik e bashkëpunëtor i imi për vite me radhë. Me bashkëpunimin tonë shumëvjeçar, me përvojën dhe profesionalizmin që e ka dëshmuar në çdo detyrë, jam i bindur se do të punojmë krah për krah, për t'i çuar përpara

projektet që i kemi nisur gjatë mandatit të Fadilit si kryetar komune, për t’u ofruar qytetarëve punë të ndershme e rezultate konkrete!”, ka shkruar Lushtaku në “Facebook”, i cili në mandatin e Fadil Nurës ishte në pozitën e nënkryetarit të komunës së Skenderajt.



ose ‘sekt’ njëri-tjetrit, më tepër e kanë që t’i flasin elektoratit të vet sesa tjetrit”, thotë Krasniqi, duke shtuar se kjo gjuhë bie ndesh edhe me edukimin qytetar dhe, për më tepër, polarizon shoqërinë në atë mënyrë që rrezikon vetë demokracinë.

Dëmtimi i demokracisë

Për rrezikimin e demokracisë tërheq vërejtjen edhe Demolli nga Lëvizja FOL. Shndërrimi i debatit publik në arenë poshtërimesh nxit

“erozionin e kulturës demokratike”, sipas saj. “Sot fillon me politikanët, nesër kalon te gazetarët, tek aktivistët, te komunitetet e te gjithë. Me një fjalë, kufiri mes kritikës politike dhe diskriminimit ka filluar të shihet më qartë”, thotë Demolli. Për Muhaxhirin, po ashtu, retorika denigruese rrezikon standardet demokratike, deformon normat publike dhe zvogëlon hapësirat për bashkëpunim qeverisës. “Radikalizimi diskursiv

ndihmon në krijimin e parakushteve psikologjike dhe sociale për projektimin e sjelljeve agresive prej politikanëve drejt elektoratit, nga studiot televizive nëpër shtëpi, institucione dhe rrugë”, thotë ai.

Si të dilet nga ky vorbull?

Sociologu Krasniqi thekson se të gjithë faktorët shoqërorë - partitë, shoqëria civile, mediat dhe qytetarët - duhet ta luajnë rolin e tyre për t’i zëvendësuar

përplasjet me debat konstruktiv mbi ide dhe programe. Por, receta të gatshme nuk ka: është një proces kompleks që kërkon pjesëmarrje të të gjithëve, sipas tij. Zeneli paralajmëron se polarizimi i kaluar e ka lënë Kosovën pa institucione për një vit dhe shton se shoqëria nuk e ka luksin ta përsërisë këtë. Demolli nuk pret ndryshime para zgjedhjeve, por mendon se mediet mund të ndikojnë duke i orientuar debatet drejt

programeve dhe ideve, jo sharjeve, dhe duke vendosur kritere që penalizojnë ofendimet në ekranet kryesore. “Pra, të vendosin rregull që kush flet me ofendime, t’i ndërpritet fjala ose të mos ftohet më në medie”, thotë ajo. Bashkëbiseduesit e REL-it presin që, pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit, partitë ta zbusin retorikën, por kryesisht për interesa të tyre, duke e përdorur si mjet për t’i lehtësuar koalicionet paszgjedhore.

Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve mbyll vitin 2025 me rezultate të plota

PRISHTINË, 4 DHJETOR - Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, i kryesuar nga Veton Shabani, mbajti takimin e fundit për këtë vit që, njëkohësisht, shënon edhe përmbylljen e mandatit

të këtij Komisioni në këtë përbërje. Në këtë takim u miratua raporti vjetor për punën e Komisionit gjatë vitit 2025 dhe u konfirmua se plani i punës për këtë vit është zbatuar në tërësi. Gjatë vitit

është vlerësuar performanca e gjashtëdhjetë e dy (62) prokurorëve, të përfshirë në shtatë (7) procese të vlerësimit. Komisioni e përmbyll këtë cikël me rezultate të qarta dhe me detyrat e realizuara

sipas planifikimit. Me këtë rast, kryetari i Komisionit, Shabani shprehu mirënjohje ndaj anëtarëve të komisionit dhe sekretarit për punën dhe angazhimin gjatë periudhës dyvjeçare sa ka kryesuar këtë takim.



BETOHEN KRYETARËT E RINJ SERBË TË KOMUNAVE NË VERI TË KOSOVËS

MITROVICË, 5 DHJETOR - Më 5 dhjetor në katër komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës kryetarët e rinj nga Lista Serbe e rimorën pushtetin. Lista Serbe ka paralajmëruar se do t'i anulojë vendimet e kryetarëve shqiptarë dhe do të kërkojë qasje në dokumentet e komunave. BE-ja pret që pushteti i ri lokal të bashkëpunojë me institucionet qendrore dhe të veprojë sipas ligjit.

Në katër komunat në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok - më 5 dhjetor u mbajtën seancat konstituive, në të cilat kryetarët e rinj nga Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - e rimorën edhe zyrtarisht pushtetin, duke e bërë betimin. Ceremonia e betimit të tyre u mbajt në prani të simboleve shtetërore të Kosovës, me raste u panë edhe flamuj të shtetit të Serbisë.

Ministri në detyrë i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, tha në "Facebook" se "gjithçka u zhvillua në rregull dhe në përputhje me dispozitat që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës" në seancat konstituive në kuvendet komunale në mbarë vendin. "Kryetarëve të rinj u uroj një mandat të suksesshëm dhe u dëshiroj punë të mbarë!", shkroi Krasniqi.

Komuna me shumicë serbe në veri u udhëhoqën nga kryetarë shqiptarë që nga maji i viti 2023, pasi ata nga Lista Serbe kishin dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022 si pjesë e largimit kolektiv të serbëve nga institucionet, në shenjë kundërshtimi me vendimet e Qeverisë së Kosovës. Lista Serbe - parti që gëzon mbështetjen e Beogradit - gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale, kishte pranuar se kishte gabuar kur ishte larguar nga institucionet dhe kishte theksuar se ky vendim ishte marrë për ta tërhequr vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar mbi "gjendjen e vështirë" të serbëve. Kryetari i Listës Serbe, Zllatan



Ellek, tha më 3 dhjetor se kryetarët e rinj të komunave, Millan Radojeviq në Mitrovicë të Veriut, Zoran Todiq në Leposaviq, Dragisha Milloviq në Zveçan dhe Millosh Peroviq në Zubin Potok, pas marrjes së detyrës, do të kërkojnë të kenë qasje në dokumentacionin e plotë. Lista Serbe, gjithashtu, më parë kishte njoftuar se do t'i anulonte vendimet "jolegjitime" që kanë marrë kryetarët shqiptarë të komunave në veri.

Pas zgjedhjeve lokale të tetorit, Bashkimi Evropian kishte deklaruar për Radion Evropë e Lirë se pret që pushteti i ri lokal në veri të Kosovës, në bashkëpunim me institucionet qendrore, në periudhën e ardhshme do të "qëndrojë konstruktiv në zgjidhjen e nevojave dhe kërkesave të popullatës përmes institucioneve dhe në përputhje me ligjet".

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parashikon se për çdo vendim ose akt tjetër të komunës, që nuk përputhet me Kushtetutën dhe ligjet, mund të kërkojë rishqyrtim nga organi mbikëqyrës - në këtë rast Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

ose institucioni tjetër përgjegjës i Qeverisë së Kosovës.

Çfarë ka ndryshuar që nga viti 2023?

Menjëherë pas marrjes së detyrës, kryetarët shqiptarë të komunave vendosën flamurin e Kosovës në ndërtesat komunale, që deri atëherë nuk shihej në asnjë institucion në veri.

Të katër komunat në veri, të banuara me shumicë serbe, iu bashkuan Asociacionit të Komunave të Kosovës, ndërsa Lista Serbe kishte deklaruar se e gjithë kjo ishte "okupim i veriut". Më pas, në bashkëpunim me autoritetet qendrore të Kosovës, u punua edhe për mbylljen e institucioneve lokale të Serbisë, si Organet e Përkohshme Komunale, Qendrat për Punë Sociale, ndërmarrjet publike komunale dhe të tjera. Gjithashtu, autoritetet lokale morën në pronësi objektet ku funksiononin institucionet serbe, ndaluan ndërtimet "jolegjitime" të financuara nga Serbia ose paralajmëruan shembjen e ndërtesave të ndërtuara pa leje. Ndërkohë, në vend të

institucioneve serbe u hapën institucione të Kosovës, poste dhe banka, dhe filloi edhe hapja e subjekteve ekonomike në pronësi të shqiptarëve, si supermarketet, restorante të ushqimit të shpejtë, dyqane ëmbëlsirash - veprime që hasën në rezistencën dhe bojkotin e komunitetit lokal serb. Komuna e Mitrovicës së Veriut në mes të këtij viti nënshkroi gjithashtu një memorandum mirëkuptimi me komunën e Mitrovicës së Jugut, i cili parashikon ndërtimin e urave mbi lumin Ibër për këmbësorë dhe automjete, një nismë që u mbështet nga Qeveria e Kosovës.

Përplasjet dhe kriza

Popullsia me shumicë serbe nuk i pranoi kryetarët shqiptarë të komunave në veri dhe shpërthyen kriza të njëpasnjëshme. Në fund të majit të vitit 2023, kur kryetarët shqiptarë morën pushtetin, ndodhi edhe një përplasje mes serbëve dhe pjesëtarëve të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, para ndërtesës së komunës së Zveçanit, ku u lënduan më shumë se 100

persona nga të dyja palët. Tensionet në veri kulmuan me sulmin nga një grup i serbëve të armatosur në Banjskë të Zveçanit, kur u vra një polic i Kosovës. Në përleshjet që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë. Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, ndërsa Prishtina e akuzoi edhe Beogradin për përfshirje, gjë që është mohuar nga Serbia.

Që nga ajo kohë, dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel politik ka qenë i bllokuar. Ndërkohë, BE-ja, e cila ndërmjetëson dialogun, në vitin 2023 vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës për shkak të përshkallëzimit të situatës në veri. Disa nga këto masa filluan të largoheshin gradualisht në maj të këtij viti.

Lidhur me heqjen e plotë të masave, burime nga BE-ja i thanë Radios Evropë e Lirë të premten se në këtë fazë nuk mund të supozohet për një vendim të heqjes së tyre, i cili, sipas tyre, do të merret nga Këshilli në momentin e duhur varësisht nga rrethanat në terren.

Fahri Restelica emërohet nënkryetar i komunës së Podujevës

PODUJEVË, 5 DHJETOR - Me vendim të kryetarit të komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, të premten është emëruar nënkryetari i komunës së Podujevës,

Fahri Restelica.

Fahri Restelica ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës. Që nga viti 2008

ka punuar si zyrtar i lartë në Agjencinë për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Fahriu për disa vjet ka qenë koordinator i Lëvizjes

Vetëvendosje Qendra në Besianë. Kryetari Bulliqi e uroi nënkryetarin Restelica për detyrën e re, duke i dëshiruar punë të mbarë e suksese.



"Hap strategjik": Kosova bëhet gati t'i ndezë motorët e mbrojtjes

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Fabrika e parë e municioneve do të ndërtohet në Jahoc të Gjakovës, me prodhimin e parë të planifikuar për fundin e vitit 2026. Ekspertët amerikanë e shohin këtë si një hap të duhur për forcimin e sigurisë. Por, paralelisht, ngrihen edhe pyetje mbi kapacitetet reale të Kosovës, sfidat teknike dhe implikimet rajonale që mund t'i sjellë kjo nismë.

Koloneli në pension i Ushtrisë amerikane, Ray Wojcik ka thënë

se një nga gjërat pozitive për Kosovën falë pranisë shumëvjeçare të misionit të NATO-s, KFOR është marrëdhënia e ngushtë dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me aleatët.

"Kosova e ka diskutuar këtë nismë veçanërisht me ShBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar, dy nga aleatët e saj më të afërt të cilët janë shumë mbështetës për të", ka thënë ai.

Ndërsa Argyro Kartsonaki nga Instituti për Kërkime të Paqes

dhe Politikat e Sigurisë pajtohet se është logjike që një shtet i vogël të përpiqet ta forcojë sigurinë e vet, por paralajmëron se këto veprime mund të perceptohen si kërcënim nga fqinjët. "Kjo nuk do t'i ndryshojë dinamikën e sigurisë në Ballkan. Ajo që mund të bëjë është t'i ushqejë narrativat, t'i jap dhe një element propagandës dhe diskurseve populiste të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq", tha ajo. (REL)



LIMAJ, I GATSHËM PËR BASHKIM PA KUSHTE ME PDK-në

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka folur për zgjedhjet e 28 dhjetorit dhe mundësinë e një bashkimi me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), duke theksuar se koha nuk është pengesë, por se gjithçka varet nga vullneti politik.

Limaj tha se ka kërkesa nga elektorati që Nisma të bashkohet me PDK-në. "Mërgimtarë, por edhe zyrtarë të PDK-së kanë kërkuar të ndodhë bashkimi. Nga deputetë me përvojë dhe drejtues të luftës është kërkuar nga unë që të bashkohem me PDK-në. Unë nuk kam dashur ta injoroj kërkesën e tyre dhe kam shprehur gatishmërinë time", u shpreh ai në "Debat Plus".

Ai shtoi se, ndryshe nga raporti me LDK-në, te PDK-ja nuk ka pasur as hezitim e as kushte.

"Te LDK-ja kam hezituar për çështjen e siglës, ndërsa te PDK-ja nuk kam pasur asnjë hezitim. Kemi shprehur gatishmërinë e plotë për të qenë në një listë të përbashkët, sepse unë ndihem rehat nën siglën e PDK-së dhe kemi qenë të gatshëm të bashkohemi pa kushte", ka thënë Limaj.

Ai theksoi se ka qenë dhe mbetet i gatshëm për një bashkim me PDK-në. "Për koalicion LDK-Nisma duhet kohë. Mendoj se për të ndërtuar diçka të përbashkët mes meje dhe PDK-së mjafton një minutë. Kur ka vullnet, duhet vetëm një minutë", deklaroi ai.

Kreu i PDK-së, Bedri Hamza, ka deklaruar se për një bashkim me Nismën e Fatmir Limajt nevojitet një kohë më e gjatë dhe një proces zgjedhor i ndryshëm.



AHMETI BËN THIRRJE PËR PJESËMARRJE MASIVE NË PROTESTËN E 13 DHJETORIT NË SHKUP: LUFTA E UÇK-SË ISHTE DHE MBETET E DREJTË



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) dhe një nga themeluesit e UÇK-së, Ali Ahmeti, ka thënë se protesta në përkrahje të çlirimtarëve që do të mbahet më 13 dhjetor në Shkup do të jetë zë i fuqishëm i qytetarëve që kërkojnë drejtësi.

Në "Facebook", Ahmeti ka thënë se lufta e UÇK-së ishte dhe mbetet e drejtë, çlirimtare dhe e mbështetur nga bota demokratike. Po ashtu, Ahmeti ka

bërë thirrje për pjesëmarrje masive në këtë protestë. "Pas Prishtinës dhe Tiranës, tani edhe Shkupi do të buçasë për të vërtetën dhe drejtësinë! Sheshi 'Skënderbeu' në Shkup do të jetë zëri i fuqishëm i qytetarëve që kërkojnë drejtësi për çlirimtarët tanë. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte dhe mbetet e drejtë, çlirimtare dhe e mbështetur nga bota demokratike. Drejtësia për luftëtarët e lirisë nuk mund të

ndërtohet mbi akuza politike, montime dhe dëshmi të fabrikuara nga Serbia dhe Rusia. Ashtu siç qëndruam përkrah luftëtarëve të UÇK-së në Prishtinë dhe Tiranë, ashtu do të qëndrojmë edhe në Shkup, krenarë, të vendosur dhe të palëkundur në mbrojtje të së vërtetës sonë, të së vërtetës objektive. Më 13 dhjetor, në orën 13:00, të gjithë në Shkup! Liria nuk gjykohet, liria mbrohet! Lavdi UÇK-së!", ka shkruar Ahmeti.

Studentët e dalluar të UP-së që morën çmimin "Hasan Prishtina" shpërblehen me nga 500 euro

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Për herë të parë në historinë e Universitetit të Prishtinës, çmimi për studentët e dalluar me emrin e atdhetarit Hasan Prishtina do të ketë vlerën monetare prej 500.00 eurove.

28 studentët e niveleve bachelor dhe master të Universitetit të Prishtinës që fituan çmimin

"Hasan Prishtina" u shpërblyen me gjithsej 14 mijë euro.

Këta studentë çmimin prestigjioz e morën në një ceremoni solemne të zhvilluar më 1 tetor 2025 në Fakultetin Filozofik, në "Ditën e Studentit" dhe përvjetorin e protestave studentore të vitit 1997 për kthimin në objektet shkollore.

Çmimi "Hasan Prishtina" është çmimi më i lartë për studentët, sipas Rregullores për procesin dhe procedurën e vendimmarrjes në përzgjedhjen e fituesve të titujve të nderit, çmimeve për studentët e dalluar dhe mirënjohjeve, që u miratua nga Senati i Universitetit të Prishtinës më 18 korrik 2025.



Rizvanolli mohon se zyrtarë të qeverisë dhe të LV-së kanë lidhje me EFT-në: Është komplet gënjeshtër

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka mbajtur të premtën konferencë për medie, në të cilën ka adresuar paqartësitë dhe dezinformatat që kanë qarkulluar lidhur me sektorin e energjisë. Gjatë konferencës u ofruan sqarime dhe informacion për çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me këtë sektor. Rizvanolli ka mohuar që ndonjë zyrtar i qeverisë dhe i Lëvizjes Vetëvendosje ka lidhje me kompaninë EFT dhe se Kosova

nuk ka importuar energji elektrike nga EFT. Ajo ka theksuar se raportimet për këto janë të pavërteta apo, siç tha, janë gënjeshtër. “Ju kam ftuar për të adresuar një sërë të pavërtetash që kanë qarkulluar që një kohë dhe kanë kulmuar gjatë javëve të fundit në lidhje me sektorin e energjisë. E para, po thuhet disi se Qeveria dhe Lëvizja Vetëvendosje janë të lidhura me kompaninë EFT. Dua ta them qartë: asnjë zyrtar i Qeverisë dhe i Lëvizjes Vetëvendosje nuk ka asnjë lidhje



me EFT-në. Është komplet gënjeshtër. E dyta; po thuhet se Kosova po importon nga EFT. Nuk ekziston asnjë fakt që

Kosova ka importuar nga EFT gjatë qeverisjes sonë, edhe kjo është komplet gënjeshtër. E treta; po keqinterpretohen qëllimshëm të dhënat e ankandeve të kapaciteteve ndërkufitare, të cilat EFT i shfrytëzon për të bartur energjinë transit në shtete tjera përmes kufijve energjetikë të Kosovës, për të krijuar bindjen se Kosova po blen nga EFT, që është pra komplet gënjeshtër. E katërta; po flitet për temën e importit të energjisë, thuajse është Qeveria ajo që blen energji. Në fakt, dua t’iu rikujtoj që Qeveria nuk blen

energji fare, ndërsa pjesa dërmuese në Kosovë blihet nga KEDS dhe KESCO për furnizim dhe humbje në rrjet, respektivisht. Këto kompani, siç e dini, janë privatizuar, para se më dhjetë vjetësh”, ka thënë ajo. Rizvanolli ka theksuar se qeveria nuk është përgjegjëse për licencim të kompanive dhe as për mbikëqyrjen e tregut e energjisë elektrike, megjithatë thotë se tashmë është e konfirmuar që gjatë qeverisjes së tyre nuk ka asnjë kontratë me EFT-në.

ÇMIMET E PRONAVE TË BANIMEVE, MË TË LARTAT NË RAJONIN E PRISHTINËS

Prishtinë, 5 dhjetor - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë Indeksin e Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) për Kosovën, duke mbuluar periudhën nga tremujori i parë (TM1) të vitit 2018 deri në tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2025, me vitin bazë 2018 = 100. Indeksi i Çmimeve të Pronave të Banimit (IÇPB) mat ndryshimet e çmimeve, duke përdorur dy tregues kryesorë: ndryshimet vjetore në përqindje (%), duke krahasuar një tremujor të vitit referues me vitin paraprak (Vjetor me Vjetor), si dhe ndryshimet tremujore në përqindje (%), duke krahasuar tremujorin referues me tremujorin paraprak (Tremujor me Tremujor). Ndërsa ndryshimet mesatare vjetore në përqindje ofrojnë një

pasqyrë të rritjes mesatare të çmimeve çdo vit. Ndryshimet mesatare vjetore në përqindje (%) për tregun e pronave të banimit në Kosovë tregojnë se rritja më e lartë në periudhën e vëzhguar ka ndodhur në vitin 2022 (4,5 %), e ndjekur nga viti 2024 (4 %) dhe nga viti 2023 (3,7 %), duke reflektuar zgjerimin e qëndrueshëm të tregut dhe kërkesën e madhe. Rritja në vitin 2021 arriti në 2,4 %, ndërsa viti 2019 regjistroi një rritje prej 2,1 %, duke treguar lëvizje të qëndrueshme në rritje pas vitit bazë 2018. Rritja më modeste ndodhi në vitin 2020 (0,2 %), duke reflektuar ngadalësimin e shkaktuar nga ndërprerjet e tregut, të lidhura me Pandeminë Covid-19. Rritjet vjetore për IÇPB ndodhën në: tremujorin e parë (TM1) 2025



Ndryshimet mesatare vjetore të përqindjes së IÇPB-së për rajonin e Prishtinës dhe rajonet e tjera të vendit (2019-2024)

Në rajonin e Prishtinës, rritja mesatare vjetore më e lartë ka ndodhur në vitin: 2021 (5,5 %); 2024 (4,7 %); 2022 (4,3 %); 2023 (2 %); dhe 2019 (1,6 %). Ndryshimi negativ vjetor u regjistrua në vitin 2020 (-0,1 %).

Për rajonet e tjera të vendit, rritja mesatare vjetore më e lartë ishte në vitin: 2023 (5,4 %); 2022 (4,4 %); 2019 (2,7 %); 2024 (2,8 %) dhe 2020 (0,6 %). Ndryshimi negativ vjetor ndodhi në vitin 2021 (-1,4 %).

(7,8 %); tremujorin e tretë (TM3) 2022 (6,1 %); tremujorin e parë (TM1) 2023 (5,5 %); tremujorin e katërt (TM4) 2024 (5,3 %); tremujorin e katërt (TM4) 2019 (5,2 %); tremujorin e dytë (TM2) 2022 (5,2 %); tremujorin e katërt (TM4) 2022 (5 %); dhe tremujori i dytë (TM2) 2023 (4,6 %), duke reflektuar periudha të rritjes së dukshme të tregut dhe rritjes së aktivitetit të transaksioneve. Rritje të tjera u regjistruan edhe në: tremujorin e tretë (TM3) 2024 (4,3 %); tremujorin e dytë

(TM2) 2025 (4,2 %); tremujorin e dytë (TM2) 2024 (3,6 %); tremujorin e katërt (TM4) 2023 (3,4 %); tremujorin e katërt (TM4) 2021 (3,4 %) dhe tremujorin e parë (TM1) 2024 (3 %), duke treguar një vrull të vazhdueshëm dhe presion në rritje mbi vlerat e pronave. Një rritje e mëtjeshme pozitive u vu re në: tremujorin e tretë (TM3) 2020 (2,7 %); tremujorin e tretë (TM3) 2021 (2,1 %); tremujorin e parë (TM1) 2022 (1,8 %); tremujorin e tretë (TM3)

2023 (1,4 %); tremujorin e parë (TM1) 2019 (0,9 %) dhe në tremujorin e parë (TM1) 2021 (0,5 %), duke treguar rritje të qëndrueshme afatgjate të vlerave të pronave të banimit. Anasjelltas, rëniet vjetore u përqendruan në vitin 2020. Rëniet më të mëdha ndodhën në tremujorin e katërt (TM4) 2020 (-2,4 %) dhe në tremujorin e dytë (TM2) 2020 (-2 %), të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin më të ulët të tregut dhe pasigurinë ekonomike.

ZËVENDËSGUVERNATORI FUSHA MBAJTI NJË LIGJËRATË MBI TË ARDHMEN E PAGESAVE DHE INOVACIONIN FINANCIAR



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Dardan Fusha, mbajti një ligjëratë në kuadër të EU Winter School 2025 me temën “Dizajnimi i së ardhmes së pagesave: si mund ta nxisë rregullimi inovacionin”. EU Winter School me titull “FinTech dhe Ekonomia Digjitale - Blockchain, Inovacioni dhe Gjeopolitika e Re e Financave Digjitale”, organizuar nga YCS

Team dhe EYCA Kosovo, me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, mbledhi studentë dhe profesionistë të rinj për të diskutuar për zhvillimet kyçe në fushën e FinTech-ut, transformimit digjital, blockchain-it, sigurisë kibernetike, kornizës rregullative dhe inovacionit në shërbimet financiare. Në prezantimin e tij, zëvendësguvernatori Fusha

theksoi evolucionin global të pagesave digjitale, shembujt në rritje të sistemeve të pagesave të shpejta dhe rolin thelbësor të rregullimit të duhur të bazuar në parime, për nxitjen e inovacionit duke mbrojtur njëkohësisht stabilitetin financiar. BQK-ja mbetet e përkushtuar për mbështetjen e inovacionit financiar, përmirësimin e qasjes në treg dhe zgjerimin e shërbimeve financiare digjitale për qytetarët, bizneset dhe ekonominë në tërësi.



Futbolli turk në krizë totale, arrestohen 46 persona për baste ilegale

ANKARA, 5 DHJETOR - Prokurorët turq kanë urdhëruar të premtën arrestimin e 46 personave, përfshirë 29 lojtarë futbolli, në një hetim të gjerë mbi bastet ilegale në ndeshjet turke. Sipas prokurorisë, 27 lojtarë dyshohet se kanë vënë

baste në ndeshjet e skuadrave të tyre, përfshirë Metehan Baltaci të Galatasaray, i suspenduar më parë për 9 muaj. Mes të arrestuarve janë edhe Mert Hakan Yandas i Fenerbahce, i cili dyshohet se ka vënë baste përmes

llogarisë së një personi tjetër. Deri tani policia ka ndaluar 35 nga 46 të kërkuarit, ndërsa pesë ndodhen jashtë vendit. Hetimi përfshin gjithashtu presidentë klubi, gjyqtarë dhe një komentator të njohur, të dyshuar për përpjekje për të ndikuar

rezultatit e ndeshjeve dhe transaksione të dyshimta financiare. Një ndeshje mes dy skuadrave të ligës së tretë, ku asnjëra nuk provoi të shënonte, ishte pikënisja e hetimit. Federata e futbollit turk ka suspenduar mbi 1 000 lojtarë, përfshirë 25 nga



Super Liga dhe rreth 150 gjyqtarë, për ta pastruar futbollin turk nga skandalet e basteve.

MBI 12 MILIONË EURO PËR TRANSFORMIMIN E TËRËSISHËM TË STADIUMIT TË PRIZRENIT

PRIZREN, 5 DHJETOR - Stadiumi “Përparim Thaçi” në Prizren po hyn në fazën më të madhe të rindërtimit në historinë e tij, pasi është nënshkruar kontrata për investimin prej mbi 12 milionë eurosh, ndërsa punët përgatitore tashmë kanë nisur. Lajmin e ka bërë me dije kryeministri Albin Kurti përmes një postimi në

“Facebook”. “Stadiumit do t’i shtohen tribunat veriore dhe jugore, duke e shndërruar në një nga arenat sportive më moderne në Kosovë”, ka shkruar Kurti. Kapaciteti i tij do të arrijë në rreth 7 800 ulëse, ku tifozët e KF Lirisë dhe sportdashësit prizrenas do të kenë një ambient bashkëkohor për ta mbështetur skuadrën e

qytetit. Kurti ka theksuar se në nivel vendi po investohen mbi 200 milionë euro në stadione të futbollit, duke synuar që Kosova ta ketë infrastrukturën më të mirë sportive në rajon. Projekti i ri pritet ta ndryshojë rrënjësisht pamjen dhe funksionalitetin e stadiumit, duke e kthyer në një qendër moderne të futbollit të Kosovës.



SUPERSFIDA NË BASKETBOLL NA PRESIN SOT DHE NESËR

PRISHTINË, 5 DHJETOR - ProCredit Superliga sa vjen e bëhet më interesante. Në xhiron e nëntë që zhvillohet në fundjavë do të zhvillohen shumë sfida interesante. Përballja e parë do të zhvillohet ndërmjet Rahoveci 029 dhe Bashkimit, që në mesjavë kanë pësuar humbje. “Vreshtarët” kanë tri fitore e pesë humbje, kurse prizrenasit pas shtatë fitoreve radhazi, kanë pësuar nga Vëllaznimi. Derbi prishtinas zhvillohet sot (e shtunë) në mes të Borës dhe



Sigal Prishtinës, por kjo sfidë do të zhvillohet në Mitrovicë. Bora

numëron dy fitore dhe pesë humbje, derisa bardhekaltrit

kanë katër fitore dhe katër humbje. Trepça dhe Vëllaznimi do të përballen nesër (e diel) në Gjakovë, ku luajnë vetëm për fitore, pasi në mesjavë kanë shënuar fitore shumë të rëndësishme. “Xehetarët” kanë pesë fitore dhe dy humbje, kurse kuqezinjtë kanë dy fitore dhe gjashtë humbje. Java e nëntë do të mbyllet me derbin verdhezi ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe GO+ Pejës, takim që zhvillohet në “Karagaçi”. Therandasit kanë dy fitore dhe

PROCREDIT SUPERLIGA-JAVA 9
E shtunë
17:00 Rahoveci 029 - Bashkimi
19:30 Bora - Sigal Prishtina
E diel
17:00 Trepça - Vëllaznimi
19:30 Golden Eagle Ylli - GO+Peja

gjashtë humbje, ndërsa pejanët kanë gjashtë fitore dhe dy humbje.

MBAPPE PRANË THYERJES SË REKORDIT TË RONALDOS TE REAL MADRIDIT



MADRID, 5 DHJETOR - Kylian Mbappe po shfaq një formë fantastike te Real Madridi dhe është shumë pranë të thyejë një rekord të Cristiano Ronaldos. Sulmuesi francez ka shënuar 55 gola në vitin 2025, vetëm katër

gola larg rekordit të Ronaldos prej 59 golash për një vit kalendarik te Los Blancos. Mbappe ka shënuar golin e 25-të këtë sezon kundër Athletic Club, në vetëm ndeshjen e 20, duke treguar ndikimin e

jashtëzakonshëm tek ekipi. Ai ka qenë i përfshirë direkt në 66 për qind të golave te Real Madridi, me 25 gola dhe 4 asistime, duke e bërë një element kyç për suksesin e skuadrës. Me pesë ndeshje të mbetura këtë vit,

përfshirë sfidat ndaj Celta Vigos, Manchester Cityt, Alavesit dhe Sevillass, Mbappe ka mundësinë reale ta thyejë rekordin e legjendës portugeze dhe ta shkruajë historinë e vet në “Bernabeu”.

Wenger: Anglia është ndër pretendentet kryesore për Kupën e Botës

LONDËR, 5 DHJETOR - Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, e ka identifikuar Kombëtaren e Anglisë si një nga pretendentet për titullin e Kupës së Botës 2026. Kombëtarja angleze e ka përfunduar fushatën

kualifikuese të Kupës së Botës pa asnjë problem. Wenger ka vë në dukje se nën drejtimin e Thomas Tuchel, Anglia ka të ngjarë të bëjë një hap më tej përpara, megjithëse ai e konsideron Francën favoritën kryesore. “Anglia do të

jetë ndër favoritët për Kupën e Botës. Ajo arrin vazhdimisht në gjysmëfinale, çerekfinale ose finale, dhe tani duhet të përparojë më tej. Ka cilësinë e nevojshme. Duke u përpjekur të mbetem objektiv, vazhdoj të kem besim te Evropa dhe Franca

është zgjedhja ime kryesore për një arsye: ka më shumë sulmues të klasës botërore sesa çdo ekip tjetër kombëtar. Të kesh një cilësi të tillë në stol në raundet eliminatorë mund të bëjë një ndryshim vendimtar”, ka thënë Wenger.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Br. 2016/1
Datum: 05.12.2025

Na osnovu članova 80 i 81 Zakona o javnim službenicima br. 08/L-197, člana 35 Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, člana 8 Zakona o radu br. 03/L-212, člana 13 Zakona o stručnom obrazovanju i osposobljavanju 04/L-138, Uredbe 19/2024 o postupcima za izbor i imenovanje direktora i zamjenika direktora, nastavnika, stručnih saradnika, asistenata, instruktora i sekretara u javnim obrazovnim i osposobljavajućim ustanovama JOOU (IEAA) preduniverzitetskog obrazovanja, Administrativnog uputstva 05/2012, Administrativnog uputstva 05/2015, Administrativnog uputstva 14/2014, Agencija za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih ASOOOO (AAAPARr), ovim objavljuje sljedeće:

KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNIH MJESTA

Agencija za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih

Centar kompetencije u Urošv cu

Naziv radnog mjesta: Direktor Centra za kompetencije
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Vrsta pozicije: Zaposlenik u javnoj službi
Klasa/Koeficijent: E 13-7.3
Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine, s mogućnošću produženja

GLAVNE RADNE OBAVEZE:

Direktor JOOU (IEAAP)-a ima izvršnu odgovornost za cjelokupno upravljanje i administraciju institucije, uključujući:

- Pripremu godišnjeg plana, plana razvoja obrazovne ustanove i godišnjih izvještaja o radu;
- Efikasno i efektivno korištenje informacionog sistema za upravljanje obrazovanjem i pridržavanje srodnih kodeksa prakse, osiguravanje i ažuriranje potrebnih podataka tokom cijele k olске godine;
- Evaluaciju nastavnika, disciplina u obrazovnoj ustanovi i druga pitanja vezana za nastavnike i druge obrazovne radnike;
- Podršku i nadzor nad implementacijom nastavnog plana i programa;
- Podržavanje i nadzor rada aktiva i stručnih saradnika obrazovne ustanove, kao i drugih mehanizama obrazovne ustanove koji imaju ulogu u procjeni učinka ustanove i upravljanju kvalitetom rada ustanove;
- Sarađuje s Upravnim vijećem obrazovne ustanove (UVŠ), Vijećem roditelja, Vijećem nastavnika, Vijećem učenika i zajednicom obrazovne ustanove.
- Izvršava UVŠ najmanje dva puta godišnje;
- Osigurava sigurno i podržavajuće okruženje za djecu/učenike u obrazovnoj ustanovi, uključujući primjenu disciplinskih mjera protiv učenika, u skladu s važećim zakonodavstvom;
- Čuvanje dokumenata i podataka, kako je propisano od strane Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacija (MONT);
- Druge pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima koje je odobrio MONT i obavezama koje proizlaze iz propisa o obrazovanju.
- Obavlja i druge poslove koje mu dodijeli direktor Agencije za stručno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje odraslih ASOOOO (AAPARr), u skladu sa zakonom;

Uslovi koje kandidati moraju ispunjavati da bi učestvovali na konkursu

- 1.1. Biti državljanin Republike Kosovo;
- 1.2. Imati punu sposobnost djelovanja, u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- 1.3. Da tečno govori najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- 1.4. Biti u stanju izvršiti odgovarajući zadatak;
- 1.5. Da ne bude osuđivan za umišljajno počinjenje krivičnog djela;
- 1.6. U javnoj ustanovi ne bi trebalo biti na snazi disciplinskih mjera za ozbiljne prekršaje;
- 1.7. Imati završeno univerzitetsko obrazovanje, nivoe kvalifikacija koji ispunjavaju uslove prema profesionalnim normama za Centre kompetencije (profesionalna priprema za relevantne profile institucije u kojoj se prijavljuju);
- 1.8. Master za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju (kvalifikacija od 300 ECTS bodova, najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- 1.9. Master obrazovanja (kvalifikacija od 300 ECTS bodova/5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- 1.10. Četverogodišnji Bachelor (kvalifikacija od 240 ECTS bodova/4 godine univerzitetskog obrazovanja);
- 1.11. Da posjeduje redovnu nastavničku licencu u skladu sa smjernicama za licenciranje nastavnika;
- 1.12. Uspješno završen program stručne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, koje nudi javna institucija odobrena od strane MONT-a;
- 1.13. Imati najmanje pet (5) godina radnog iskustva kao nastavnik na ASOOOO (AAAPARr).
- 1.14. Da uspješno prođe procedure prijema propisane važećim zakonodavstvom.

U trenutku prijave, kandidati moraju posjedovati sljedeću dokumentaciju:

- Završena fakultetska diploma za odgovarajući nivo kvalifikacije prema tačkama 1.7, 1.8, 1.9 ili 1.10 ovog člana;
- Certifikat o uspješno završenom programu obuke za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju, zasnovanom na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, koji nudi javna institucija odobrena od strane MONT-a;
- Ako je kandidat završio Master studijski program iz oblasti rukovođenja, administracije ili menadžmenta u obrazovanju, nije dužan dostaviti dokaz/certifikat o obuci iz oblasti liderstva u obrazovanju u skladu sa tačkom 1.12. ovog člana;
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveno uvjerenje izdato u posljednjih šest mjeseci od strane licencirane zdravstvene ustanove, kojim se dokazuje zdravstveno stanje pacijenta;
- Dokaz da nije osuđivan/a za umišljajno počinjeno krivično djelo;
- Ne bi trebalo biti na snazi disciplinske mjere za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- Ovjera radnog iskustva u obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da kandidat u posljednje tri godine nije obavljao

- nikakvu vodeću funkciju u strukturama političke stranke;
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputama u obrascima Uredbe 19/2024 o postupcima za izbor i imenovanje direktora i zamjenika direktora, nastavnika, stručnih saradnika, asistenata, instruktora i sekretara u javnim obrazovnim i osposobljavajućim ustanovama (IEAA) preduniverzitetskog obrazovanja;
- Za pozicije direktora škole, kandidati podnose koncept plana razvoja škole, koji konkretno opisuje metodu i strategiju putem koje će se poboljšati upravljački kvalitet škole, nastava i rezultati učenika.
- Kandidati koji su diplomirali izvan Kosova moraju imati diplome nostrificirane od strane MONT-a;
- Dokumentacija za prijavu, kako je definirana u ovom članu, dostavlja se u štampanom obliku uredu i u roku navedenom u javnom oglasu.

Informacije o pristupu planu razvoja odgovarajuće IEAA

Znajući da je koncept Razvojnog plana odgovarajuće obrazovne ustanove jedan od Tačke za pripremu profesionalnog portfolija, Plan razvoja institucije, možete dobiti u Centru za kompetencije u Uroševcu.

Evaluacija kandidata

- Procjena znanja, vještina i profesionalnih kvaliteta kandidata vrši se putem:
- Pismeni test**, koji čini 50% ukupne ocjene i ima ukupno 100 bodova,
- Usmeni intervju** čini 50% ukupne ocjene, 30% predstavljanje koncepta plana razvoja škole, a 20% profesionalni portfolio.
- Komisija vrši konačan izbor pobjedničkog kandidata sa najvećim brojem bodova, ali najmanje 70% od ukupnog broja bodova prema odgovarajućem obrascu ove Uredbe.
- Uži izbor kandidata pozvanih na pismeni test i usmeni intervju, kao i raspored intervjuja, bit će obaviješten putem e-pošte i telefona.
- Konačni rezultati evaluacije bit će poslani kandidatima putem e-pošte, objavljeni na oglasnoj tabli škole i na <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Rok i način prijave

Konkurs ostaje otvoren 30 kalendarskih dana od dana objavljivanja od datuma **06.12.2025** do datuma **04.01.2026**.

Podnošenje dokumenata se vrši u Agenciji za obrazovanje i stručno osposobljavanje i obrazovanje odraslih (AAAPARr). Adresa: Ulica „Agim Ramadani“ 10000, Priština, treći sprat, radno vrijeme od 09.00-15.00. Zahtjev je primljen i dostavljen administraciji AAAPARr-a.

U prijavi mora biti jasno naveden naziv radnog mjesta, a dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i neće biti vraćeni, osim diploma ovjerenih kod notara.

Samo informacije koje su dokazane relevantnim dokumentima (ne samo navedene u prijavi) smatraju se tačnim i istinitim informacijama;

Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe s invaliditetom i nedovoljno zastupljeni spol imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost kako je određeno važećim zakonodavstvom.

Ako se kandidati prijavljuju za dva ili više radnih mjesta, kandidati moraju podnijeti odvojene prijave za svako radno mjesto.

Napomena: Sve nepotpune prijave, netačne i očigledne propuste u prijavnom obrascu, te one podnesene izvan službenog roka navedenog u ovom konkursu neće biti razmatrane.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 14-25

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtarëve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin: Dosja për: Kontratë për Auditim Funksional dhe Financiar të OMK-së**

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **12.12.2025 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **15.12.2025 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **15.12.2025 ora 12:00.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.2018/1
Datë: 05.12.2025

Bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 08/L-197, nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenin 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Rregulloren 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Udhëzimit administrativ 05/2012, Udhëzimit administrativ 05/2015, Udhëzimit administrativ 14/2014, Agjencia e AAPARR-së, shpall këtë:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Qendra e Kompetencës në Ferizaj

Titulli i vendit të punës: Zëvendësdrejtor i Qendrës të Kompetencës

Numri i pozitave: Një (1) pozitë

Lloj pozitës: Nëpunës i shërbimit publik

Klasa/Koeficienti: E 14-7.2

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi

Detvrat kryesore të punës :

Zëvendësdrejtor për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave

- Zv. drejtori, është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave;
- Zv. drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave;
- Organizimin e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të nxënësve dhe kandidatëve për tregun e punës përmes ofrimit të kurseve afatshkurtra dhe afatgjata;
- Organizimin e panairëve për prezntimin dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Qendrave të Kompetencës;
- Dhënen me qira të hapësirave me pajisjet e nevojshme për bizneset private;
- Mbështetje në ofrimin e shërbimeve këshilluese për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe nxënësit e QK përkatëse;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimit të nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit për të mundësuar punësimin e të diplomuarve dhe kandidatëve;
- Siguron trajnime dhe aftësime të vazhdueshme që përshtaten me nevojat e tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendësdrejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare dhe në rast të mungesës së drejtorit, e zëvendëson atë;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënit;
- Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/esha e agjencisë së AAPARR-së, në pajtim me ligjin.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për Qendrat e Kompetencës (përgatitje profesionale për profile përkatëse të institucionit ku konkurron);
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Master nga fushat e Ekonomisë (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit/es sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit sipas pikave 1.7, 1.8, 1.9, 1.10 apo 1.11 të këtij neni;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzoj dëshminë/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim sipas pikës 1.13 të këtij neni;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portofolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në formularët e Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar;

- Për pozitat e drejtorëve të shkollave, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës, i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës, mësimdhënia dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI;
- Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar me këtë nen, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar me konkurs publik.

Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatës

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, Planin Zhvillimor të institucionit mund ta merrni në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim**, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë;
- Intervista me gojë**, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm, 30% prezentimi i konceptit të planit zhvillimor të shkollës dhe 20% portlfolio profesionale;
- Komisioni bën përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues të vlerësuar me më së shumti pikë, por të paktën 70% të pikëve totale sipas formularit përkatës të kësaj Rregulloreje;
- Lista e ngushtë e aplikuesve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave ,do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit;
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do t’u dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit nga dt. **06.12.2025** deri me dt. **04.01.2026**. Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAPARR). Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAPARR-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen, përveç diplomave të noterizuara.

